



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria – Vlada – Government*

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih Poslova / Ministry of Internal Affairs

# **STRATEGJIA SHITETËRORE**

## **KUNDËR DROGAVE**

### **2024 - 2028<sup>1</sup>**

**Prill 2024**

---

<sup>1</sup> Strategjia Shtetërore Kundër Drogave 2024-2028 është miratuar me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. x të datës x

## Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive .....	3
Lista e shkurtesave .....	5
1 HYRJE .....	7
2 METODOLOGJIA.....	9
3 SFONDI .....	10
4 VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË.....	15
5 ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT .....	19
6 NDIKIMI BUXHETOR DHE ZBATIMI I STRATEGJISË .....	22
7 PLANI I VEPRIMIT 2024-2026 .....	25

## Përmbledhje ekzekutive

Strategjia Shtetërore Kundër Drogave 2024-2028 është dokumenti kryesor kornizë i politikave shtetërore në fushën e drogave. Strategjia elaboron problemet me të cilat shoqëria e Kosovës ballafaqohet aktualisht në fushën e drogave duke filluar nga prezenca e drogës, kërkesa e rritur, dëmet që shkaktohen nga droga por edhe paraqet nevojën për ngritje të përgjithshme të kapaciteteve institucionale qoftë për hetimin dhe luftimin e dukurisë së drogës, trajtimin adekuat të personave që përdorin drogë dhe personave me çrregullim të përdorimit të substancave, si dhe rritjen e bashkëpunimit në mes të institucioneve, e veçanërisht nevojën për të dhëna specifike në këtë fushë.

Marrë parasysh problemet e identifikuara, vizioni i kësaj Strategjie është ulja e prezencës dhe konsumimit të drogës në Kosovë, duke zvogëluar kështu pasojat negative që sjell droga dhe krijuar një shoqëri të shëndetshme, të sigurtë dhe ekonomikisht aktive. Kështu Strategjia parasheh gjithsej katër objektiva kryesore të cilat synohen të arrihen: 1. Zvogëlimi i ofertës dhe furnizimit me drogë – rritja e sigurisë; 2. Zvogëlimi i kërkesës për drogë; 3. Adresimi i dëmeve që lidhen me drogën dhe 4. Fuqizimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe atij ndërkombëtar. Këto objektiva ndahen pastaj në qëllime tjera specifike, ku parashihen treguesit afatmesëm dhe afatgjatë për arritjen e tyre.

Strategjia ka edhe Planin e Veprimit të saj ku parashihen aktivitete të veçanta për arritjen e këtyre katër objektivave. Në kuadër të objektivit për zvogëlimin e ofertës dhe furnizimit me drogë, institucione përgjegjëse janë kryesisht agjencitë e zbatimit të ligjit dhe fokusi është në aktivitete që kanë për qëllim parandalimin e krimit, shkatërrimin e grupeve të organizuara në fushën e drogave dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve, gjegjësisht pasurisë së fituar përmes drogës. Këtu parashihen edhe veprime për të intensifikuar mbikëqyrjen dhe monitorimin e rrugëve të drogës, veçanërisht kufijve dhe dërgesave postare, por edhe laboratorëve të mundshëm që shërbejnë për prodhimin e tyre. Në përputhje me këtë, parashihen edhe aktivitete që kontribuojnë në ndërprerjen e kanaleve të distribuimit të drogës në masa të vogla dhe të mesme brenda vendit. Objektivit tjetër që është zvogëlimi i kërkesës për drogë si institucion përgjegjës kryesor e ka Ministrinë e Shëndetësisë, përfshirë klinikat që kujdesen për trajtim dhe rehabilitim të personave që përdorin drogë dhe personave me çrregullim të përdorimit të substancave, por edhe institucione tjera që përfshihen sidomos në pjesën e parandalimit të drogave. Kur jemi te parandalimi, aktivitetet e planifikuara në Strategji do të kenë fokus shkollat dhe industrinë apo vendet e argëtimit ku është prezent rinia. Tek aspekti i trajtimit, aktivitetet janë të fokusuara drejt ngritjes së kapaciteteve të shërbimeve shëndetësore të lartpërmendura, por edhe sigurimit të qasjes në këto shërbime për të gjitha kategoritë pa dallim.

Përveç parandalimit, trajtimit dhe rehabilitimit, Strategjia parasheh edhe aktivitete specifike për risocializimin dhe ri-integrimin në shoqëri të personave që përdorin drogë. Këto veprime ndërlidhen edhe me veprimet tjera në kuadër të objektivit 3 që ka të bëjë me adresimin e dëmeve lidhur me drogën, ku parashihen aktivitete për të zvogëluar rrezikun nga sëmundjet infektive lidhur me drogën, si dhe aktivitetet për të parandaluar mbidozën tek personat që përdorin drogë. Gjithashtu, në kuadër të këtij objektivit parashihen aktivitete për të kufizuar përdorimin e drogës në burgje dhe adresimin e nevojave shëndetësore dhe shoqërore të të burgosurve gjatë vuajtjes së dënimit dhe pas lirimit. Aktivitete tjera shumë të rëndësishme janë paraparë në kuadër të objektivit të fuqizimit të bashkëpunimit ndër-institucional dhe atij ndërkombëtar, ku parashihet veçanërisht krijimi i sistemit të mbledhjes dhe

shkëmbimit të informacionit dhe të dhënave në mes të institucioneve, por edhe aktivitete për të ngritur kapacitetet e shërbimit shëndetësor përmes bashkëpunimit me shtetet tjera, si dhe ndërmarrje e aktiviteteve të përbashkëta të agjencive të zbatimit të ligjit me agjencitë simotra të tyre në shtetet tjera, apo organizata evropiane dhe ndërkombëtare për hetimin dhe luftimin e krimit.

Përfundimisht Strategjia parasheh ndikimin buxhetor që pritet nga zbatimi i aktiviteteve të lartpërmendura, por edhe aspektet institucionale, veçanërisht rolin e Ministrit të Punëve të Brendshme si Koordinator Shtetëror Kundër Drogave, Sekretariatit të Strategjisë dhe Observatorit të Drogave por edhe Ekipit Koordinues Ndër-institucional në fushën e Drogave, që do ta kenë në monitorimin e zbatimit të kësaj Strategjie dhe raportimin e rregullt përkatës. Strategjia do të ketë edhe dy vlerësime, një afatmesëm dhe një përfundimtar në fund të vitit 2028, kur edhe do të përfundoj cikli kohor i kësaj Strategjie.

## Lista e shkurtesave

AAPSK – Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar  
AFK – Agjencia e Forenzikës së Kosovës  
AKI – Agjencia e Kosovës për Inteligjencë  
AKPPM – Agjencia e Kosovës për Pajisje dhe Produkte Medicinale  
BE – Bashkimi Evropian  
DSHB – Departamenti Shëndetësor i Burgjeve  
DHTN – Drejtorati për Hetimin e Trafikimit me Narkotikë  
EMCDDA – Qendra Monitoruese Evropiane për Drogat dhe Varësinë ndaj Drogave  
ESPAD – Projekti i Sondazhit të Shkollave Evropiane për Alkoolin dhe Drogat tjera  
HAPE – Projekti për Punë të Brendshme i Bashkimit Evropian në Kosovë  
ICITAP – Programi Ndërkombëtar për Hetime Penale dhe Asistencë në Trajnime  
IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës  
IML – Instituti për Mjekësi Ligjore  
IPK – Inspektorati Policor i Kosovës  
KGJK – Këshilli Gjyqësor i Kosovës  
KPK – Këshilli Prokurorial i Kosovës  
MASHTI – Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Inovacionit  
MKRS – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës  
MPB – Ministria e Punëve të Brendshme  
MSH – Ministria e Shëndetësisë  
NJIF – Njësia për Inteligjencë Financiare  
OJQ – Organizata Jo-qeveritare  
OSBE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë  
PK – Policia e Kosovës  
PSRK – Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

QKMK – Qendra Kombëtare për Menaxhim Kufitar

QPS – Qendra për Punë Sociale

SHKK – Shërbimi Korrektues i Kosovës

SHSK – Shërbimi Sprovues i Kosovës

SHSKUK – Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës

UNDP – Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara

# 1 HYRJE

Përdorimi i drogës shkakton probleme të rënda për individin. Kur përdorimi përhapet tek shumë individë, atëherë kjo gjendje ndikon gjithashtu shoqërinë dhe ekonominë e një vendi. Situata rëndohet tutje kur personat që përdorin drogë krijojnë çrregullim të përdorimit të substancave, duke rritur kështu rrezikun për sëmundje nga ose të ndërlidhura me drogën që mund të kenë edhe pasoja fatale për individin, apo përfshirjen e tyre në veprimtari tjera, siç është kriminaliteti. Droga lidhet drejtpërdrejtë edhe me fenomene tjera negative, si krimi i organizuar, shpërlaje e parave, trafikimi me njerëz, prostitucioni dhe të tjera. Droga pra është një nga burimet e problemeve tjera që krijohen.

Në Republikën e Kosovës aktualisht nuk dihet numri i saktë i personave që rregullisht përdorin drogë. Përshtypjet janë që ekziston një rritje viteve të fundit, veçanërisht tek personat e rinj. Marihuana dhe hashishi duket se janë substancat më të përdorura, ndërsa përdorimi i kokainës ka shënuar gjithashtu rritje, krahasuar me heroinën e cila ka rënie. Përveç drogave tanimë të njohura, në treg janë prezente gjithashtu drogat sintetike si ‘amfetamina’, ‘ekstazi’, veçanërisht ‘mdma’, pastaj ‘ghb’, ‘lsd’, ‘crack’ dhe të tjera<sup>2</sup>. Megjithatë, sipas të dhënave të ESPAD në vitin 2019<sup>3</sup>, Kosova, krahasuar me vendet evropiane, vazhdon të jetë vendi me disponueshmërinë më të vogël të drogave. Sipas këtyre të dhënave, disponueshmëria e ‘kanabisit’ tek të rinjtë<sup>4</sup> është 11%, dukshëm më e ulët se mesatarja e vendeve evropiane e studiuar nga ESPAD, e që është 32%.<sup>5</sup> Poashtu, ‘ekstazi’ sipas këtij studimi është i disponueshëm 4.7% në krahasim me mesataren evropiane prej 14%. Tutje, ‘amfetamina’ 2,8% në krahasim me mesataren 10%, ‘metamfetamina’ 2,9% krahasuar me 8.5%, ‘kokaina’ 5% krahasuar me 13%, dhe ‘crack’ 3.1% krahasuar me mesataren evropiane 10% nga të intervistuarit.<sup>6</sup> Me disa përjashtime të vogla, sipas këtij sondazhi, meshkujt janë më të prirur për të përdorur drogat se femrat.<sup>7</sup> Të dhënat për Kosovën tregojnë poashtu përqindje më të vogël të fëmijëve nën moshën 13 vjeçare që kanë provuar substanca, krahasuar me mesataren evropiane p.sh. kanabisi në Kosovë 1.7% krahasuar me mesataren 2.4%. Kosova sipas këtyre të dhënave poashtu ka numrin më të vogël të personave që përdorin drogat e paligjshme rregullisht gjatë jetës 4.2%, krahasuar me mesataren evropiane prej 17% nga të intervistuarit.<sup>8</sup>

Arsyeja pse njerëzit fillojnë të përdorin droga janë të ndryshme, përfshirë disponueshmërinë e drogave në treg, traumën e fëmijërisë së hershme, mungesën e informacionit mbi rreziqet e përdorimit të drogave, presionin shoqëror, kureshtjen për të provuar gjëra të reja dhe arsye të tjera.

Që nga themelimi i institucioneve të Republikës së Kosovës, janë ndërmarrë hapa seriozë drejt adresimit të problematikës së drogës. Përmes Strategjisë së fundit Kundër Drogave 2018-2022 dhe veprimeve

---

<sup>2</sup> Drogat sintetike janë substance psikoaktive që prodhohen përmes një procesi kimik në të cilin përbërësit thelbësor psikoaktivë nuk rrjedhin nga substanca natyrale. “Synthetic drugs” 2001. EMCDDA. Faqe 43. E qasshme në: [https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/201/sel2001\\_3en\\_69551.pdf](https://www.emcdda.europa.eu/system/files/publications/201/sel2001_3en_69551.pdf)

<sup>3</sup> ESPAD Report 2019. Results from European School Survey Project on Alcohol and Other Drugs. I qasshëm në: <http://espad.org/espad-report-2019>

<sup>4</sup> Të rinjtë sipas këtij sondazhi kanë përfshirë studentët që kanë mbushur moshën 16 vjeçare dhe të cilët kanë qenë prezent në klasë gjatë zhvillimit të sondazhit

<sup>5</sup> ESPAD Report 2019, faqe 36-37.

<sup>6</sup> Po aty, faqe 38.

<sup>7</sup> Ibid.

<sup>8</sup> Po aty, faqe 49.

konkrete që kanë rrjedhur nga ajo Strategji, janë arritur rezultate të rëndësishme në luftimin e drogave, trajtimin dhe rehabilitimin e personave që përdorin drogë, risocializimin dhe riintegrimin e tyre, si dhe adresimin e dëmeve të lidhura me drogat. Por natyrisht që këto veprime duhet të avancohen tutje dhe të parashihen veprime të reja në të ardhmen, duke përcjell me kujdes dinamikën e zhvillimit të këtij fenomeni shoqëror negativ në Kosovë.

Në këtë drejtim, Ministria e Punëve të Brendshme në vitin 2023 ka themeluar grupin punues për hartimin e Strategjisë së re Kundër Drogave 2024-2028 dhe Planin e Veprimit, me përbërje ndër-institucionale dhe përfshirje të sektorit jo-qeveritar. Strategjia synon uljen e prezencës dhe përdorimit të drogave në Kosovë, reduktimin e pasojave negative që sjell droga dhe si rrjedhojë krijimin e një shoqërie të shëndetshme, të sigurt dhe ekonomikisht aktive.

Duke ditur që problemet e drogës janë të ndërlidhura në formë zingjirore, por edhe shumë-dimensionale, veprimet që planifikohen në këtë Strategji synojnë të adresojnë të gjitha aspektet e drogave. Kështu, parashihen veprime të institucioneve të zbatimit të ligjit për të ndaluar hyrjen e drogës në Kosovë apo prodhimin e saj, veprime të institucioneve shëndetësore për të trajtuar dhe rehabilituar në mënyrë efektive personat që përdorin drogë, veprimet e institucioneve në përgjithësi për risocializimin dhe riintegrimin në shoqëri të këtyre personave, por edhe për të parandaluar sëmundje apo edhe vdekje që mund të shkaktohen nga mbidoza (overdoza) me drogën. Të gjitha këto parashihen të bëhen me një përfshirje të rëndësishme të sektorit jo-qeveritar por edhe me bashkëpunim ndërkombëtar me shtete dhe organizata evropiane apo ndërkombëtare, përmes projekteve zhvillimore në Kosovë.

Kjo Strategji është dokumenti kryesor kornizë i politikave shtetërore në fushën e drogave. E njëjta është në përputhje të plotë me Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025, ku ndër të tjera paraqitet vizioni i qeverisë për parandalimin dhe luftimin e krimit<sup>9</sup>, rritjen dhe ruajtjen e sigurisë publike<sup>10</sup>, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve shëndetësore.<sup>11</sup> Gjithashtu, Strategjia është në linjë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim, gjegjësisht Qëllimin Strategjik III – Siguria dhe Sundimi i Ligjit.

Përveç pjesës hyrëse dhe metodologjike të hartimit të saj që e përbëjnë dy kapitujt e parë, në Kapitullin III paraqitet Sfondi i Strategjisë ku evidentohen zhvillimet e fundit dhe problemet ekzistuese në fushën e drogave në Kosovë, pastaj në Kapitullin IV – Vizioni dhe Objektivat e Strategjisë, përcaktohet vizioni, objektivat strategjike (gjithsej 4) dhe qëllime specifike (gjithsej 11) që synohen të arrihen nga Qeveria e Kosovës deri në vitin 2028. Tutje, në Kapitullin V paraqiten aranzhimet e zbatimit, monitorimit dhe raportimit me synim të ndërtimit të një sistemi efikas të zbatimit dhe adekuat të monitorimit, ku rolin kryesor do ta ketë Sekretariati i Strategjisë në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si dhe Ekipi koordinues ndër-institucional i cili do të shërbej si Ekipi kryesor në Republikën e Kosovës në fushën e drogave dhe që bashkëpunon ngushtë me Observatorin e Drogave, por si dhe vet Ministri i Punëve të Brendshme si Koordinator Shtetëror Kundër Drogave. Kapitulli VI paraqet koston e zbatimit të Strategjisë, gjegjësisht të veprimeve të planifikuara në Planin e Veprimit të Strategjisë që është pjesë përbërëse e saj.

---

<sup>9</sup> Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2021-2025. f.16. I qasshëm në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2022/04/Programi-i-Qeverise-se-Kosoves-2021-2025.pdf>

<sup>10</sup> Po aty

<sup>11</sup> Faqe 10

## 2 METODOLOGJIA

Siç u përmend në pjesën hyrëse të kësaj Strategjie, Ministria e Punëve të Brendshme me vendim ka themeluar grupin punues për hartimin e Strategjisë në përbërje të zyrtarëve nga kjo Ministri; Ministria e Shëndetësisë përfshirë Departamentin Shëndetësor të Burgjeve dhe Klinikën e Psikiatrisë; Zyra e Kryeministrit; Policia e Kosovës; Agjencia e Forenzikës; AKI; Dogana e Kosovës; MASHTI; NJIF; KPK/PSRK; KGJK; Shërbimi Korrektues; Inspektorati Mjedisor; MKRS; OJQ 'Labirint' dhe përfaqësues të projekteve zhvillimore ndërkombëtare në Kosovë.

Anëtarët e këtij grupi punues kanë paraqitur pikëpamjet e tyre me shkrim, janë takuar disa herë në kuadër të grupit dhe kanë mbajtur një numër të punëtorive, ku të gjithë pjesëmarrësit kanë paraqitur pikëpamjet e tyre lidhur me kapitujt e ndryshëm të Strategjisë e veçanërisht me problematikat të cilat hasen dhe veprimet që planifikohen të adresohen.

Raportet e zbatimit nga Strategjia e kaluar Kundër Drogave 2018-2022 dhe veçanërisht përvoja gjatë zbatimit dhe problematikat që janë hasur, kanë qenë burim kryesor i informatave lidhur me hartimin e kësaj Strategjie. Në hartim janë marrë parasysh edhe raporte të rregullta institucionale, siç janë raportet e institucioneve të zbatimit të ligjit: Policia e Kosovës, Dogana, NJIF, etj, pastaj dokumentet dhe raportet e Ministrisë së Arsimit sa i përket fushës së parandalimit të drogave, tutje raportet e Ministrisë së Shëndetësisë institucioneve shëndetësore dhe të dhënat që ato i posedojnë lidhur me trajtimin e rehabilitimit, si dhe raportet dhe informatat nga institucionet tjera, lidhur me risocializimin dhe riintegrimin e personave që përdorin drogë. Burim i rëndësishëm i informatave dhe të dhënave kanë qenë edhe të dhënat e sektorit jo-qeveritar, të cilët ndër vite kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë të përfshirë në mënyrë aktive në këtë fushë.

Raportet ndërkombëtare kanë shërbyer po ashtu si burim esencial për hartimin e kësaj Strategjie. Këtu janë marrë parasysh raporte dhe udhëzues nga organizata të ndryshme, e veçanërisht ato të institucioneve të BE-së si Komisioni Evropian dhe EMCDDA, të cilat vazhdimisht përcjellin progresin e Kosovës kundër drogave. Raporti i vitit 2023 për Kosovën<sup>12</sup> ka nënvizuar të arriturat dhe sfidat që Kosova i ka në këtë drejtim. Këto të gjetura janë elaboruar tutje në Kapitullin III të kësaj Strategjie.

Përveç këtyre burimeve të informatave, janë zhvilluar intervista të targetuara me zyrtarë institucional dhe me ekspertë nga sektori jo-qeveritar, me pyetje të parapërgatitura, të cilat kanë ndihmuar në identifikimin e problematikave dhe hartimin e veprimeve që synojnë t'i adresojnë ato. Këto intervista zakonisht janë përcjellë edhe me dërgimin e dokumenteve, informatave dhe komenteve shtesë me shkrim të cilat kanë plotësuar tutje Strategjinë.

Marrë parasysh aspektin ndërkombëtar të trafikimit të drogës, por edhe rëndësinë e bashkëpunimit me shtetet dhe organizatat jashtë Republikës së Kosovës, në hartim të Strategjisë është vlerësuar edhe Strategjia e Drogave e BE-së 2021-2025 dhe Plani i Veprimit që kanë shërbyer për identifikimin e problematikave që BE i ka në këtë drejtim e të cilat kanë ndikim edhe për Kosovën, por edhe zgjedhjet dhe mundësitë për bashkëpunim që mund të krijohen. Gjatë hartimit, janë marrë parasysh edhe përvojat e shteteve tjera në këtë drejtim.

---

<sup>12</sup> I qasshëm në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2023\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/kosovo-report-2023_en)

Për draft Strategjinë është zhvilluar edhe procesi i konsultimit paraprak dhe publik, ku institucionet përkatëse dhe sektori jo-qeveritar, si dhe publiku në përgjithësi e kanë pasur mundësinë të ofrojnë pikëpamjet e tyre për Strategjinë. Hartimi i Strategjisë është mbështetur gjithashtu nga Projekti i BE-së HAPE në Kosovë dhe nga OSBE, përmes ekspertizës specifike të ofruar dhe është ndarë me EMCDDA për vlerësimin e tyre. Strategjia është finalizuar në muajin Prill 2024 dhe pastaj është miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

### 3 SFONDI

Përveç problemit individual, droga është problem shoqëror i cili kërkon qasje dhe zgjidhje të koordinuara për të luftuar atë. Në Kosovë aktualisht është një numër i madh i institucioneve që kanë kompetenca në këtë fushë, si dhe janë duke adresuar problemet e lidhura me të. Bashkëpunimi në mes tyre është kyç për të arritur rezultate të rëndësishme në këtë fushë.

Ministria e Punëve të Brendshme është institucioni kryesor koordinues. Në kuadër të kësaj Ministrie, gjegjësisht Sekretariatit të Strategjive, vepron Observatori i Drogave. Roli i Observatorit të Drogave është mbledhja e të dhënave dhe monitorimi i drogave në nivel shtetëror, analizimi dhe interpretimi i të dhënave të mbledhura, dhe raportimi dhe publikimi i të dhënave në këtë fushë.<sup>13</sup> Bashkëpunimi i Observatorit të Drogave dhe institucioneve të Kosovës me EMCDDA vazhdon të jetë në nivel të kënaqshëm. Në kuadër të Sekretariatit të Strategjive vepron gjithashtu Zyrtari i Lartë për Strategjinë Kundër Drogave, me rol mbështetës në hartimin dhe monitorimin e Strategjisë Kundër Drogave. Sipas Rregullores së brendshme të Ministrisë në kuadër të këtij Sekretariati, parashihet edhe pozita e Zyrtarit përgjegjës për Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm për substancat e reja psikoaktive, por që rekrutimi për këtë pozitë nuk është zhvilluar ende. Fuqizimi i Observatorit të Drogave dhe funksionalizimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm janë kyçe për koordinimin ndër-institucional, gjegjësisht planifikimin, ndërmarrjen dhe monitorimin e veprimeve të veçanta kundër drogave në Kosovë.

Policia e Kosovës bashkë me Doganën si agjenci të zbatimit të ligjit, në bashkëpunim edhe me agjenci tjera si NJIF, AKI dhe të tjera, ndërmarrin masa vazhdimisht që të ndalohet hyrja apo prodhimi i drogës në territorin e Kosovës dhe droga e cila lokalizohet të konfiskohet, e në të njëjtën kohë personat që trafikojnë drogën të arrestohen dhe vendosen para drejtësisë. Institucionet e sistemit të drejtësisë – Prokuroria dhe Gjykata në anën tjetër sigurojnë që këto raste të hetohen në përputhje me ligjin dhe personat për të cilët vërtetohet kryerja e veprës penale, të marrin dënimet e merituar. Agjencia e Forenzikës ka përgjegjësi në kryerjen e ekspertizave forenzike profesionale dhe sipas standardeve ndërkombëtare dhe menaxhimin e data-bazave forenzike, sa i përket ndër të tjera edhe drogave. Linja 24 orëshe lidhur me abuzimin e drogave është gjithashtu funksionale.

Policia e Kosovës vepron gjithashtu në aspektin parandalues të përdorimit të drogave duke udhëzuar, ofruar siguri në bashkësi dhe ulur mundësinë për qytetarët, e veçanërisht të rinjtë të përdorin drogat. Ministria e Arsimit në bashkëpunim me drejtoritë komunale të arsimit dhe shkollat kanë rol në parandalimin e përdorimit të drogave tek nxënësit por edhe referimin e rasteve të identifikuara për trajtim të mëtutjeshëm. Rol parandalues ka edhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit përmes masave

---

<sup>13</sup> Building a national drugs observatory: a joint handbook. 2010. f. 21. E qasshme në: [https://www.emcdda.europa.eu/publications/joint/ndo-handbook\\_en](https://www.emcdda.europa.eu/publications/joint/ndo-handbook_en)

intervenuese drejt fuqizimit dhe mbështetjes së rinisë përmes politikave rinore dhe projekteve konkrete, por edhe promovimit të sportit si alternativë ndaj fenomeneve negative që ndikojnë rininë, në këtë rast droga.

Përderisa Ministria e Shëndetësisë përcakton politikat shëndetësore, Ministria siguron edhe trajtimin me metadon. Ky trajtim bëhet në institucione publike shëndetësore të nivelit sekondar në spitale, repartet psikiatrike në Gjakovë, Pejë, Prizren dhe Gjilan, ndërsa në nivel terciar në Klinikën Psikiatrike të QKUK-së, por edhe Departamentin Shëndetësor të Burgjeve dhe në institucione private të licencuara nga Ministria Shëndetësisë. Klinika e Psikiatrisë në kuadër të QKUK ka repart të veçantë kundër varësisë me kapacitete prej 12 shtretërve dhe ku bëhet detoksikimi i personave që përdorin drogë dhe ofrohet trajtimi me metadon.

Risocializimi dhe riintegrimi i personave që përdorin drogë duhet të përfshijë institucione të ndryshme, si qendrat për punë sociale në nivel lokal e deri tek Shërbimi Korrektues dhe Shërbimi Sprovues të cilat ushtrojnë kompetencat e tyre përkatëse për këta persona që bien ndesh me ligjin për shkak të përdorimit të drogave.

Përveç prezencës së drogës në treg, droga shpesh provohet të futet edhe në burgje, andaj Shërbimi Korrektues i Kosovës siguron që kjo mos të ndodhë apo të konfiskohet nëse haset brenda tyre. Personat që përdorin drogë dhe personat me çrregullim të përdorimit të substancave shpesh kryejnë edhe vepra tjera penale dhe përfundojnë në burgje. Në këtë aspekt, Departamenti Shëndetësor i Burgjeve në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë, duhet të siguroj trajtim adekuat të tyre dhe minimizoj rreziqet nga sëmundjet e dëmet tjera që mund të shkaktohen për ta por edhe rrezikun nga mbidoza.

Duke parë rolet e ndryshme që kanë institucionet e lartpërmendura, kuptohet se drogat shkaktojnë një zingjir të problemeve dhe nevojave të ndryshme. Fillimisht problemet shkaktohen nga prezenca e drogës në territorin e Kosovës, që vjen nga territoret e vendeve tjera. Me ofertën dhe furnizimin me drogë rritet edhe niveli i përdorimit të drogës, veçanërisht nëse nuk ndërmerren masat parandaluese apo këto masa nuk kanë efekt. Përdorimi shkakton edhe çrregullim të përdorimit të substancave, duke shkaktuar kështu pasoja shëndetësore të cilat kanë nevojë të trajtohen. Për tu bërë të aftë për zhvillim të jetës normale, personat që përdorin drogë duhet të rehabilitohen, por edhe pastaj të risocializohen dhe riintegrohen.




Figura 1 - Zingjiri i problemeve dhe nevojave që shkaktohen nga droga

Raporti i Komisionit Evropian i vitit 2023 thekson që Kosova vazhdon të jetë vend i deponimit dhe transitit të drogës.<sup>14</sup> Sukseset e Policisë së Kosovës dhe agjencive tjera të zbatimit të ligjit kanë qenë të vazhdueshme në zbulimin dhe konfiskimin e drogave. Gjatë vitit 2022 ka pasur veçanërisht operacione të suksesshme për zbulimin e laboratorëve kultivues në pjesën veriore të Kosovës. Por marrë parasysh nivelet e prezencës së drogës në Kosovë dhe interesit të madh financiar që grupet kriminale kanë në këtë drejtim, kapacitetet dhe operacionet institucionale duhet të rriten edhe më tutje në këtë drejtim, ashtu që konfiskimi të jetë edhe më i madh. Veçanërisht është e rëndësishme që të ngritet niveli i kuptimit të tregut të drogës përmes punës analitike dhe veprimeve të inteligjencës.<sup>15</sup> PSO e Policisë për hetimin e drogave ka nevojë të përditësohet duke marrë parasysh trendet e trafikimit të drogave dhe praktikave të zhvilluara deri tani. Kultivimi i kanabisit në ambiente të mbyllura është vazhdimisht më i popullarizuar në Ballkanin Perëndimor, duke përcjellur trendët evropiane dhe botërore<sup>16</sup>, andaj edhe Policia e Kosovës duhet të alokoj resurset e nevojshme dhe vazhdoj tutje detektimin e individëve dhe grupeve të krimit të organizuar që kultivojnë kanabis në ambiente të mbyllura.

Sa i përket drogave sintetike, në përgjithësi duhet të rriten kapacitetet e agjencive të zbatimit të ligjit për kuptimin e tyre e veçanërisht ato të reja që mund të hyjnë në treg, e për të cilat Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm luan një rol të rëndësishëm. Gjithashtu, duhet të ngriten kapacitetet për hulumtimin e ndërlihdjes së drogave me kriptovalutat por edhe trafikimi i drogës që ndodh përmes internetit (qoftë nga dark web nga shtetet tjera në Kosovë apo brenda Kosovës, si mënyrë e komunikimit për shitblerje). Shkëmbimi i informatave në mes të agjencive të zbatimit të ligjit në përgjithësi ka nevojë gjithashtu të përmirësohet tutje.<sup>17</sup>

Viti	Nivelet e konfiskimit
2022	662 kg kanabis, 246 kg heroinë dhe 4 kg kokainë.
2021	500 kg kanabis, 3.6 kg heroinë dhe 414 kg kokainë
2020	256.7 kg kanabis, 8.9 kg heroinë dhe 2.7 kg kokainë
2019	824,2 kg kanabis, 7,7 kg heroinë dhe 1,5 kg kokainë
2018	800 kg kanabis, 120 kg heroinë dhe 1 kg kokainë

*Tabela 1 - Nivelet e drogës së konfiskuar gjatë 5 viteve të fundit<sup>18</sup>*

Sa i përket drogave të konfiskuara, dispozitat ligjore janë të duhura për shkatërrimin e tyre por që mungon një protokoll që shpjegon procedurën hap pas hapi për trajtimin, ruajtjen dhe shkatërrimin.<sup>19</sup> Në mungesë të protokollit, droga e konfiskuar ndër vite ende nuk është shkatërruar.

<sup>14</sup> Faqe 49

<sup>15</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën. 2023. Faqe 50

<sup>16</sup> Indoor cannabis cultivation is a growing industry in Kosovo. Global Initiative Against Transnational Organized Crime. 2023. E qasshme në: <https://riskbulletins.globalinitiative.net/see-obs-015/03-indoor-cannabis-cultivation-a-growing-industry.html>

<sup>17</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën. 2023. Faqe 50

<sup>18</sup> Burimi: Raportet vjetore të Policisë së Kosovës dhe raportet e Komisionit Evropian për Kosovën. Po ashtu ndër vite janë konfiskuar një numër i caktuar i drogave sintetike. Raporti i Policisë vitit 2022 tregon një sasi prej 412 gr të prekursorëve të konfiskuar, 281.5 gr ekstazi, 91.31 metamphetamine, 5 ml metadon, 0.5 gr tablet , 65.8 gr kristale të panjohura, 4.2 MDMA, 60 tableta tramadol, 482 gr substance formë pluhuri (nuk dihet lloji), 3 shishe GLB, 9 tableta mjekësore, 100 tableta DBOLMAX, 7.9 gr këpurdha dhe 2 tableta LSD.

<sup>19</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën. 2023. Faqe 49

Policia e Kosovës vazhdon të hap raste të reja ndaj personave të cilët trafikojnë drogë, posedojnë drogë apo kultivojnë/prodhojnë atë. Përveç ngritjes së kapaciteteve të Policisë, Prokuroria duhet gjithashtu të ngrit efikasitetin në hetimin e këtyre veprave penale, duke siguruar staf të mjaftueshëm dhe të trajnuar.<sup>20</sup> Trendi i numrit të personave të arrestuar dhe dënuar vazhdon të jetë pothuajse i njëjtë gjatë viteve, por marrë parasysh përshtypjen e përgjithshme për rritjen e numrit të personave që përdorin drogë, këta numra duhet të rriten veçanërisht për trafikantët e drogës.

Për personat që përdorin drogë zakonisht shqiptohen dënime me gjobë dhe me kusht (si masë alternative). Por edhe kur shqiptohen dënimet me kusht, ato rrallë herë përcillen me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues apo detyrime tjera të caktuara, të cilat do të mundësonin që personat që përdorin drogë të rehabilitohen dhe mos përsërisin kryerjen e veprës penale. Me shqiptimin e këtyre masave në të ardhmen duhet të rriten edhe kapacitetet e SHSK-së për mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Në përgjithësi duhet të rritet bashkëpunimi polici, prokurori dhe gjykatë në këtë drejtim, duke ndarë informatat relevante për vështirësitë e shkaktuara gjatë hetimit dhe gjykimet apo edhe ndarjen e praktikave më të mira, por edhe me SHKK-në dhe SHSK-në gjatë ekzekutimit të sanksioneve penale ashtu që ato të arrijnë efektin e duhur. Kur jemi të luftimi i drogës, vlen të theksohet gjithashtu se ka nevojë të përmirësohet bashkëpunimi, koordinimi dhe shkëmbimi i informatave në mes të agjencive të zbatimit të ligjit në rajonin e Ballkanit Perëndimor.<sup>21</sup>

Viti	Arrestimet dhe gjykimet
2022	1039 persona të arrestuar, 539 raste të hapura ndaj 791 të dyshuarve: 271 për trafikim të drogës, 505 për posedim dhe 32 për kultivim.
2021	726 raste të hapura ndaj të dyshuarve: 218 për trafikim të drogës, 478 për posedim, 29 për kultivim dhe një për drogat tjera.  Gjatë këtij viti 1117 persona janë akuzuar dhe 390 janë dënuar nga Gjykata.
2020	1,006 raste të hapura ndaj të dyshuarve: 170 për trafikim, 802 për posedim dhe 33 për kultivim.  Gjatë këtij viti 1217 persona janë akuzuar dhe 367 janë dënuar nga Gjykata.
2019	1,396 janë akuzuar dhe 534 persona janë dënuar nga Gjykata.
2018	385 persona të dënuar nga Gjykata.

Tabela 2 - Arrestimet dhe gjykimet për veprat penale të trafikimit, posedimit apo kultivimit/prodhimit të drogës.<sup>22</sup>

Ashtu si për veprat tjera penale, edhe konfiskimi i aseteve të ndërlydhura me drogën duhet gjithashtu të rritet. Si rrjedhojë, duhet në veçanti të zbatohen në mënyrë efikase dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që mundësojnë këto, si dhe të fillohet zbatimi i Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me Vepër Penale.

<sup>20</sup> Po aty

<sup>21</sup> Po aty

<sup>22</sup> Burimi: Raportet e Komisionit Evropian për Kosovën

Gjithsesi, parandalimi i përdorimit të drogës luan një rol të rëndësishëm, para se të diskutohet efikasiteti i dënimeve dhe konfiskimeve. Pavarësisht një numri të madh të aktiviteteve parandaluese, ato duket se nuk kanë arritur efektin e plotë të synuar. Nuk ka aktualisht programe të strukturuar në nivel shtetëror për parandalimin e përdorimit të drogave. Gjithashtu, vlen të theksohet se aktivitetet parandaluese qoftë nga institucionet si MASHTI, komunat, Policia dhe të tjera kanë pasur kryesisht në fokus shkollat, ndërsa më pak industrinë apo vendet e argëtimit veçanërisht për të rinjtë. QPS-të aktualisht janë fare pak të përfshira në aktivitetet parandaluese.

Problemi i kuptimit të drogave vazhdon të jetë edhe problem ligjor në Kosovë. Ligji për Barnat Narkotike (2007) mbetet i vjetër dhe ka nevojë të miratohet ligji i ri në përputhje me *acquis*.<sup>23</sup> Zbatimi i ligjit aktual në fuqi ka krijuar vështirësi, veçanërisht sa i përket kuptimit dhe ndalimit në treg të drogave sintetike të reja. Ministria e Shëndetësisë udhëheq me grupin punues të projektligjit të ri në këtë drejtim, dhe i njëjti pritet të miratohet gjatë vitit 2024. Ka vështirësi posaçërisht edhe në mbledhjen e të dhënave për drogat në Kosovë, pasi që Sistemi Informativ Shëndetësor nuk ka filluar të zbatohet ende. Ka nevojë që Kosova të krijoj një sistem rutinor të mbledhjes së të dhënave në përputhje me standardet dhe protokollet e BE-së

Sa i përket trajtimit të personave që përdorin drogë, në Kosovë siç u cek më lartë ofrohet trajtimi ndaj çrregullimit të përdorimit të substancave dhe trajtimi me metadon.<sup>24</sup> Gjithsesi, kapacitetet e ofruesve publik shëndetësor mbesin shumë të ulëta. Kosova ende nuk e ka një Institut për Sëmundjet e Varësisë. Shërbimet për trajtimin e fëmijëve që përdorin drogë në sistemin publik shëndetësor, veçanërisht kanë nevojë të zhvillohen. Po ashtu, duhet marrë parasysh kategoritë më të cenuara siç mund të jenë gratë shtatzëna apo komunitetet jo-shumicë si komuniteti rom, komuniteti ashkali dhe komuniteti egjiptian. Përfshirja e nivelit sekondar shëndetësor dhe atij primar shëndetësor (së paku në nivel të ngritjes së vetëdijes), duket të jetë shumë e ulët. Përveç trajtimit dhe rehabilitimit, risocializimi dhe riintegrimi i personave që përdorin drogë është kyç që këta persona të fillojnë një jetë të re dhe të shmangin pasojat shëndetësore e dëmet tjera, si dhe të jenë ekonomikisht aktiv. Duket se aktualisht programet në këtë drejtim nuk janë të mjaftueshme.

Përveç këtyre, adresimi i dëmeve të ndërlidhura me drogën është i rëndësishëm të prioritizohet. Duhet të rriten masat parandaluese për shpërndarjen e sëmundjeve infektive që ndërlidhen me drogat si HIV, Hepatit C, etj. Ende nuk dihet numri i saktë i personave që vdesin nga mbidoza, mirëpo raste të tilla janë raportuar ndër vite. Rreziku i dëmeve nga droga por edhe mbidoza është i vazhdueshëm për personat që përdorin drogë në Kosovë. Duke marrë parasysh që personat që përdorin drogën, shpesh përfundojnë në burgje, jo vetëm si pasojë e veprës penale të përdorimit, por edhe veprave tjera të ndërlidhura siç janë vjedhjet, rrahjet, dhuna në familje, prostitucioni apo edhe vepra tjera më të rënda, duhet të merren masa shtesë për parandalimin e futjes së drogave në burgje. Por, edhe të sigurohet një trajtim shëndetësor adekuat i personave që përdorin drogë, të cilat janë duke vuajtur dënimet në burgje.

---

<sup>23</sup> Raporti i Komisionit Evropian për Kosovën. 2023. Faqe 48.

<sup>24</sup> Po aty. Faqe 49.

## 4 VIZIONI DHE OBJEKTIVAT E STRATEGJISË

Vizioni i Strategjisë Kundër Drogave është ulja e prezencës dhe konsumimit të drogës në Kosovë, duke zvogëluar kështu pasojat negative që sjell droga dhe krijuar një shoqëri të shëndetshme, të sigurt dhe ekonomikisht aktive.

Për të zbatuar praktikisht këtë vizion dhe adresuar problemet dhe sfidat e identifikuara në Kapitullin 3 të kësaj Strategjie, janë zhvilluar katër (4) objektiva strategjike me objektivat specifike të tyre, në kuadër të të cilave do të planifikohen aktivitete konkrete për arritjen e tyre.

<b>Objektivi 1</b>	<b>Objektivi 2</b>	<b>Objektivi 3</b>	<b>Objektivi 4</b>
Zvogëlimi i ofertës dhe furnizimit me drogë – rritja e sigurisë	Zvogëlimi i kërkesës për drogë	Adresimi i dëmeve që lidhen me drogën	Fuqizimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe atij ndërkombëtar
<b>Qëllimet specifike</b>			
1 - Parandalimi i krimit, shkatërrimi i grupeve të organizuara në fushën e drogave dhe sekuestrimi e konfiskimi i aseteve	1 - Parandalimi i përdorimit të drogës	1 - Zvogëlimi i rrezikut dhe dëmit nga përdorimi i drogës	1 - Standardizimi i shkëmbimit të informacionit në mes të institucioneve
2 - Intensifikimi i mbikëqyrjes dhe monitorimit të trafikimit dhe prodhimit të drogës	2 - Sigurimi i qasjes dhe forcimi i shërbimeve të trajtimit, kujdesit dhe rehabilitimit të personave që përdorin drogë	2 - Kufizimi i përdorimit të drogës në burgje dhe adresimi i nevojave shëndetësore dhe shoqërore të të burgosurve gjatë vuajtjes së dënimit dhe pas lirimit	2 - Krijimi i programeve të reja të bashkëpunimit me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare për çështjet shëndetësore lidhur me drogën
3 - Ndërprerja e kanaleve të distribuimit të drogës në masa të vogla dhe mesme	3 - Risocializimi dhe ri-integrimi në shoqëri i personave që përdorin drogë		3 - Krijimi i programeve të reja të bashkëpunimit me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare për çështjet e sigurisë

Me qëllim të zvogëlimit të ofertës për drogë (Objektivi 1) parashihet të ndërmerren një seri aktivitete të ndryshme nga agjencitë përgjegjëse të zbatimit të ligjit. Që të arrihet sukses në zbatimin e masave për zvogëlimin e ofertës së drogave dhe shkatërrimin e grupeve të organizuara kriminale me droga dhe prekursorë, janë të nevojshme të parashihen aktivitete për angazhimin, koordinimin dhe bashkëpunimin e organeve të zbatimit të ligjit dhe institucioneve të sistemit të drejtësisë. Aktivitete tjera që do të parashihen në kuadër të këtij objekti janë ato lidhur me ndryshimin e protokolleve të caktuara, përmirësimin e hetimeve, ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve policor, doganor dhe të agjencive tjera, pastaj aktivitete që synojnë rritjen e konfiskimit dhe masa tjera që kanë të bëjnë me luftimin e drogave.

Aktivitetet në kuadër të Objektivit 1 do të ndahen në tri pjesë sipas objektivave specifike. Institucionet kryesore përgjegjëse për zbatimin e këtyre aktiviteteve do të jenë Policia e Kosovës, Dogana e Kosovës, NJIF, AKI dhe agjencitë tjera, pastaj KGJK dhe KPK, por edhe inspektorate si Inspektorati Farmaceutik dhe Inspektorati Mjedisor. Zbatimi i një pjese të këtyre aktiviteteve do të bëhet nga buxheti i Kosovës, ndërsa pjesa tjetër do të përkrahët nga projekte zhvillimore të ndryshme në këtë fushë si Projekti HAPE, OSBE, ICITAP, UNDP dhe të tjera. Tregues kryesor i Objektivës 1 do të jetë vlerësimi i Kosovës në Raportin vjetor të Komisionit Evropian sa i përket Kapitullit 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria, ky tregues do të jetë edhe treguesi i përgjithshëm kryesor për objektivat tjera. Për Objektivën 1, tregues do të jenë edhe disponueshmëria e perceptuar e substancave në bazë të sondazhit të ESPAD, por edhe rezultatet e tregut kriminal sipas Global Organized Crime Index. Tregues specifik për Objektivën 1 do të jetë niveli i konfiskimit të drogave, duke përfshirë drogat sintetike në Kosovë.

Objektivi i zvogëlimit të kërkesës për drogë (Objektivi 2) fillimisht synohet të arrihet përmes aktiviteteve të cilat parandalojnë përdorimin e drogës, që synojnë zvogëlimin e numrit të personave që përdorin drogën dhe arritjen e vetëdijes përmes edukimit për pasojat që sjell përdorimi i drogës për individët dhe shoqërinë. Këtu parashihen kampanja, udhëzues dhe masa tjera parandaluese të cilat do të synojnë shkollat, kafiteritë, klubet e natës. Përveç kësaj, me aktivitetet parandaluese synohet edhe të rritet roli i sektorit jo-qeveritar në këtë drejtim, veçanërisht organizatave rinore, por edhe roli i shëndetësisë primare në drejtim të këshillimit drejt parandalimit të drogës.

Pas parandalimit, zvogëlimi i kërkesës për drogë përfshin aspektin e trajtimit dhe rehabilitimit të personave që përdorin drogë, por edhe risocializimit dhe riintegrit të tyre. Aktivitetet që parashihen këtu janë kryesisht sa i përket zhvillimit të kapaciteteve trajtuese dhe rehabilituese. Zvogëlimi i kërkesës gjithashtu përfshinë veprimet konkrete dhe që ndërmerren për trajtim dhe rehabilitim vullnetar ose të obligueshëm për personat me çrregullim në përdorim të substancave, me qëllim zvogëlimin e dëmeve. Për më shumë, do të krijohen programe për risocializim dhe riintegrim, si dhe do të ndërmerren masa tjera për të mundësuar këtë, për personat që përdorin drogë. Tregues specifik i Objektivës 2 do të jetë numri i personave që përdorin drogë, si dhe përqindja e fillimit të përdorimit të hershëm të substancave (nën moshën 13 vjeçare) bazuar në sondazhin e ESPAD.

Aspekti i trajtimit të dëmeve lidhur me drogat përfshin aktivitete që parandalojnë shpërndarjen e sëmundjeve ngjitëse të lidhura me drogat, si testime vullnetare, programe dhe të tjera, përmirësimin e udhërrëfyesve klinikë apo edhe ngritjen e kapaciteteve lidhur me ofrimin e ndihmës së parë nga Policia për personat në mbidozë. Një pjesë e rëndësishme i kushtohet edhe zgjerimit të programit me terapi mbajtëse në burgje për personat që përdorin drogë, por edhe masat që duhet të merren për testimin e të burgosurve, këshillimet e ndryshme gjatë dhe para se të përfundohet ekzekutimi i sanksioneve penale, por

edhe monitorimi i personave që përdorin drogë. Tregues kryesor i Objektivës 3 do të jetë numri i personave të infektuar me sëmundje ngjitëse të ndërlidhura me drogat dhe numri i personave të vdekur nga mbidoza.

Aspekti i bashkëpunimit institucional dhe fuqizimi i kapaciteteve të brendshme është synim në kuadër të Objektivit 4. Hulumtimi dhe analiza e të dhënave mund të luajnë një rol vendimtar në arritjen e të gjitha objektivave të kësaj Strategjie. Këto procese ofrojnë informacion thelbësor për të kuptuar më mirë problemin e drogës, për të identifikuar tendencat, për të identifikuar zonat kritike dhe për të zhvilluar ndërhyrje të synuara. Hapi i parë është mbledhja e të dhënave të sakta dhe të përditësuara mbi trafikun e drogës, personat që përdorin drogë, tregjet e paligjshme dhe organizatat kriminale të përfshira. Ekspertët e analizës së të dhënave mund të përdorin algoritme dhe modele statistikore për të identifikuar tendencat kryesore, të tilla si tendencat në çmimet e barnave, ndryshimet në modelet e konsumit dhe rrugët e trafikimit. Analiza e të dhënave mund të ndihmojë gjithashtu në identifikimin e organizatave kriminale të përfshira në trafikun e drogës, duke përfshirë strukturat e tyre, udhëheqësit kryesorë dhe lidhjet ndërkombëtare.

Gjeo-lokalizimi i të dhënave mund të ndihmojë në identifikimin e zonave gjeografike me probleme veçanërisht serioze të trafikut të drogës. Këto zona më pas mund të synohen për ndërhyrje për të reduktuar disponueshmërinë e drogës dhe për të përmirësuar parandalimin dhe trajtimin e çrregullimit të përdorimit të substancave. Mbledhja dhe analiza e të dhënave mundëson gjithashtu vlerësimin e efektivitetit të politikave dhe strategjive aktuale kundër narkotikëve. Ky reagim është thelbësor për të bërë ndryshime dhe përmirësime në strategjitë e vazhdueshme. Meqenëse informacioni kundër narkotikëve mund të jetë shumë i ndjeshëm, është thelbësore të sigurohet siguria e të dhënave dhe të mbrohen ato nga ndërhyrja ose rrjedhja e informacionit. Si rrjedhojë, një ndër aktivitetet kryesore që do të parashihet këtu është krijimi i regjistrit për trajtimet shëndetësore të drogave, në kuadër të IKSHPK-së. Funkcionalizimi i këtij regjistri do të jetë treguesi specifik kryesor në kuadër të Objektivës 4. Në planin afatmesëm, është i nevojshëm edhe krijimi i Sistemit Informativ të Drogave përmes të cilit do të mblidhen të dhënat kyçe dhe monitorohen indikatorët e shëndetësisë dhe sigurisë në fushën e drogave.

Fuqizimi i kapaciteteve të Observatorit të Drogave dhe rekrutimi e fuqizimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm janë aktivitete tjera që do të parashihen në këtë objektiv e që janë të rëndësishme për bashkëpunimin ndër-institucional të përmendur më lartë. Në përgjithësi roli koordinues i MPB-së parashihet të fuqizohet e që përcillet me ngritjen e kapaciteteve të institucioneve tjera të përfshira për zbatimin e kësaj Strategjie. Bashkëpunimi në mënyrë efikase në mes të institucioneve është kyç për arritjen e rezultateve në fushën kundër drogave.

Problematika e ofertës së drogave në Republikën e Kosovës gjithsesi nuk është e izoluar, por një aktivitet i tillë varet nga gjendja momentale e trafikimit të paligjshëm edhe në aspektin ndërkombëtar. Duke marrë parasysh përpjekjet ndërkombëtare që bëhen në këtë drejtim, në kuadër të Objektivit 4 do të parashihen aktivitete për ngritjen e bashkëpunimit me vendet e Ballkanit Perëndimor dhe shtetet anëtare të BE-së. Aktivitete për shkëmbimin e përvojave dhe mësimin e trendëve apo teknikave të reja, janë të nevojshme për agjencitë e zbatimit të ligjit në Kosovë. Përveç pjesës së luftimit të drogave, bashkëpunimi ndërkombëtar do të përfshijë dhe aspektin e bashkëpunimit për trajtimin dhe rehabilitimin e personave që përdorin drogë, ku ngjashëm planifikohet shkëmbimi i përvojave apo specializimi i profesionistëve jashtë vendit. Gjithashtu do të parashihen aktivitete për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar, veçanërisht sa i përket aspektit të monitorimit të zbatimit të sanksioneve. Ky Objektiv do të përfshijë pothuajse të gjitha institucionet përgjegjëse në tre objektivat e parë. Bashkëpunimi ndërkombëtar do të forcojë shumë

aftësinë e institucioneve të Kosovës për të trajtuar trafikun e drogës brenda vendit, pasi që shumë nga drogat e trafikuar siç u cek më lartë, kalojnë kufijtë ndërkombëtarë. Tregues specifik në kuadër të kësaj objektive do të jenë rasatet e bashkëpunimit me shtetet tjera me ndikim në trajtimin e personave që përdorin drogë, si dhe numri i operacioneve të përbashkëta të agjencive të zbatimit të ligjit me shtetet tjera.


## 5 ARANZHIMET E ZBATIMIT, MONITORIMIT DHE RAPORTIMIT

Procesi i zbatimit të Strategjisë do të synojë përmbushjen e objektivave strategjike, atyre specifike dhe aktiviteve të veçanta në kuadër të Planit të Veprimit. Monitorimi dhe vlerësimi i rezultateve të zbatimit të objektivave dhe aktiviteve do të jetë pjesë përbërëse e procesit të strategjisë, si dhe element kryesor në përmbushjen e saj. Plani i Veprimit i Strategjisë ka përcaktuar përgjegjësitë institucionale për zbatimin e aktiviteve. Këto institucione do të raportojnë në mënyrë të rregullt për zbatimin e tyre.

Ministri i Punëve të Brendshme si Koordinator Shtetëror Kundër Drogave e ka rolin kryesor në koordinimin ndër-institucional kundër drogave në Kosovë. Sekretariati i Strategjive, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, do të jetë bartës i procesit të monitorimit e zbatimit të Strategjisë dhe hartimit të raporteve të zbatimit. Institucionet zbatuese do të përbëjnë Ekipin Koordinues Ndër-institucional në fushën e Drogave, që do të mbështesin Observatorin e Drogave në ushtrimin e kompetencave. Ky Ekip në veçanti do të jetë në gjendje të koordinoj të gjitha aktivitetet e nevojshme kundër drogave, të mbledh dhe raportoj të dhënat tek Observatori, por edhe në veçanti të vlerësoj dhe miratoj raportet e rregullta të zbatimit të kësaj Strategjie. Përbërja e Ekipit Koordinues do të përcaktohet me Vendim të Ministrit të Punëve të Brendshme dhe do të përfshijë të gjitha institucionet që janë kompetente për të zbatuar aktivitetet e kësaj Strategjie, duke përfshirë edhe përfaqësuesit e sektorit jo-qeveritar.

Ky Ekip do të takohet në baza të rregullta (së paku çdo 3 muaj) për të siguruar koordinimin në zbatimin e aktiviteve, raportimin e të dhënave dhe monitorimin. Pas miratimit nga ana e Ekipit Koordinues, raportet e rregullta të Zbatimit të Strategjisë si më poshtë, parashihet të miratohen nga Ministri i Punëve të Brendshme. Përmes monitorimit pra, do të bëhet mbledhja e vazhdueshme dhe sistematike e të dhënave për matjen e progresit dhe zbatimi i Planit të Veprimit. Parashihet të përgatiten gjithsej dy raporte të rregullta:

1. Raporti gjashtëmuor për zbatimin e Planit të Veprimit të Strategjisë, ku do të prezantohen të arriturat dhe sfidat në zbatimin e aktiviteve të planifikuara, dhe
2. Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë, ku përveç të dhënave nga Raporti gjashtëmuor, do të prezantohet gjithashtu niveli i arritjes së objektivave përmes treguesve të caktuar, shpenzimet buxhetore të krijuara dhe informacione tjera në përputhje me Manualin për Monitorimin e Dokumenteve Strategjike.




*Figura 2 - Përgjegjësitë institucionale në zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë kundër Drogave*

Plani i Veprimit i Strategjisë 2024-2026 do të rishikohet në baza vjetore nga Ekipi Koordinues Ndërinstitucional dhe më së largu deri në Dhjetor të vitit vijues. Plani i ri i Veprimit do të miratohet pastaj nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe Qeveria.

Rishikimi afatmesëm i Strategjisë Kundër Drogave do të bëhet në fund të vitit 2026, kur do të përditësohet pjesa narrative e Strategjisë dhe do të hartohet Plani i ri i Veprimit në dy vitet e fundit. Versioni i rishikuar i Strategjisë dhe Plani i ri i Veprimit, gjithashtu do të miratohen nga Ministri i Punëve të Brendshme dhe Qeveria. Raportimi për zbatimin e Planit të Veprimit dhe të Strategjisë do të vazhdoj edhe në këtë fazë në mënyrë të njëjtë si për vitet paraprake.

Deri në Dhjetor të vitit 2028 do të bëhet vlerësimi përfundimtar i Strategjisë Kundër Drogave për të kuptuar nivelin e përgjithshëm të zbatimit të aktiviteteve dhe arritjen e objektivave të përcaktuara. Kjo fazë do të përkoj edhe me planifikimet për hartimin e Strategjisë së re e cila do të pasoj pas vitit 2028.



